

VËSHTRIM SEMANTIKO – STRUKTUROR MBI SINTAGMËN EMËRORE ME MARRËDHËNIE PËRCAKTORE NË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT

LIRI SEITLLARI

Shkolla e mesme "Muharrem Collaku", Pogradec, ALBANIA
seitllariliri@gmail.com

AKTET V, 4: 682-686, 2012

PERMBLEDHJE

Dritëro Agolli e përpunon gjuhën natyrore në veprat e tij dhe e ngre në një rrafsh të dytë artistik. Ai ka aftësinë që t'ju krijojë fjalëve mundësinë që të futen në lidhje të reja fjalësore me qëllim që ato të shpërfaqin më shumë forcë, shumanësi e mendim dhe lidhjet e tyre të tingëllojnë gjithnjë të reja, të freskëta e befasuese. Në poezinë e tij gjejmë disa gjedhe strukturore-semantike sintagmash: sintagma emërore me marrëdhënie përcaktore; sintagma emërore me marrëdhënie ndajshtimore; sintagma metaforike me lidhje kallëzuesore; sintagma metaforike me lidhje atributive. Vendin më të madh në të e zenë sintagmat metaforike emërore-përcaktore. Nëpërmjet tyre, dukuritë e rëndomta e prozaikë, në mekanizmin tepër veprues të metaforës së Agollit shndërrohen në të bukura.

Fjalë kyçe: sintagma, lidhje metaforike përcaktore, semantikë, figurshmëri

SUMMARY

D. Agolli processes natural language in his works and he lifts on second level of artistic plane . He has the capacity to give the words the opportunity to enter in new connections of words in order to show with power , different points and thought ; and their connections to sound always new , fresh and astounding . In his poetry we can find some structural-semantic cattle of syntagmas : Nominative syntagmas with determinant relation, nominative syntagmas with apposition relation, metaphorical syntagmas with predicative relation , metaphorical syntagmas with attributive relations . The largest place in it busy the metaphorical syntagmas with nominative-determinative relation .Through them , common occurrences of prosaic,in overly action mechanism of Agolli metaphore transform in beautiful.

Key words: syntagma, poetry, semantic, concept, overview.

1. Hyrje

Në lidhje me rëndësinë e gjuhës në një vepër letrare R.Hasan vëren se "në artin fjalësor, gjuha nuk është si veshja për trupin, ajo është vetë trupi" (Hasan, 1989: 91). Në këtë studim do të analizojmë ndjeshmërinë e veçantë të D. Agollit ndaj gjuhës, do të vërejmë se si e përpunon gjuhën natyrore në veprat e tij dhe e ngre në një rrafsh të dytë artistik. Ai na mëson "se si mund të gdhendet fjala shqipe në mënyrë që të shkëlqejë në poezi me tërë forcën dhe madhështinë e saj" (Shkurtaç, 2009: 132). Ai ka aftësinë që t'ju krijojë fjalëve mundësinë që të futen në lidhje të reja

fjalësore me qëllim që ato të shpërfaqin më shumë forcë, shumanësi e mendim dhe lidhjet e tyre të tingëllojnë gjithnjë të reja, të freskëta e befasuese.

Në poezinë e Agollit gjejmë disa gjedhe strukturore-semantike sintagmash metaforike: sintagma emërore me marrëdhënie përcaktore; sintagma emërore me marrëdhënie ndajshtimore; sintagma metaforike me lidhje kallëzuesore; sintagma metaforike me lidhje atributive. Nga vëzhgimi tërësor i veprës poetike të Agollit del se vendin më të madh në të e zenë

sintagmat metaforike të grupit të parë, prandaj do të ndalemi hollësisht në analizën e tyre.

2. Sintagma emërore me marrëdhënie përcaktore

2. 1. Sintagma metaforike dygjymtyrëshe emër+emër

Një marrëdhënie mbi të cilën ndërtohen strukturat e figurshme emër + emër është marrëdhënia përcaktore. Gjymtyra e dytë e sintagmës përcaktore mund të jetë një emër në rasën gjinore të të dyja trajtave, një emër në rasën rrjedhore të pashquar, një emër me parafjalë. Në vend të emrit në gjinore mund të kemi ndonjëherë një përemër pronor të vetës së tretë, atëherë lidhja ndërmjet sintagmave është e tërthortë, si për shembull: **“Tokë e dashur, të lashë ca vjet me dëshirën tënde djerrë”** (*Lypësi i kohës*, f. 196).

Natyrisht, për ndërtimin e strukturës së figurshme do të zëvendësojmë përemrin me emrin që ka rimarrë ai, pra kjo strukturë do të ishte **“Dëshira e tokës”**.

Të lidhur me gjymtyrët e strukturës mund të ketë edhe përcaktorë të tjerë, të cilët nuk ndikojnë në marrëdhënien e figurshme: **“E zbuluan frutin e fshehur nga diktatura e dimrit totalitar”** (*Lypësi i kohës*, f. 122)

Sintagmat emërore me marrëdhënie përcaktore në poezitë e Agollit, formohen nga lidhja e figurshme e dy gjymtyrëve të cilat janë:

a) emër + emër në rasën gjinore: *dhëmbi i zallit, diktatura e bukurisë, diktatura e dimrit, drejtësia e gjakut, jelet e Drinit etj.*

b) emër + emër në rasën rrjedhore: *deng mjegullash, disk gjumash, ëndrra perëndish, mjegull pikëllimi, pësh- pëshje shpirtrash, thonj eksitimi etj.*

c) emër + emër në rasën kallëzore e rrjedhore me parafjalë: *bark me përralla, enigmë prej yjesh, fjalë me mjaltë, fjalë pa krahë, përrenj me mjaltë shtet nën kosë etj.*

d) emër + mbiemër: *cjap ashik, ëndrra të blerta, dimri totalitar, gjumë i trëndafiltë, livadh politik etj.*

Të afërta me to janë edhe ndërtimet me përcaktorë një emër në rrjedhore pa parafjalë

dhe kjo është e kuptueshme, përderisa trajtat e gjinore së shquar janë në një farë mënyre edhe të rrjedhore së shquar. Po ndërmjet këtyre rasave ka edhe dallime kuptimore e funksionale që vërehen në kufizimet strukturore. Kështu, kur emri në gjinoren e shquar përdoret me kuptim të individualizuar, ai nuk mund të kthehet në rrjedhore të pashquar ndonëse marrëdhëniet ndërmjet nocioneve janë po ato, pasi emri në trajtë të pashquar e shënon fushën nocionore në mënyrë të përgjithësuar, duke e cilësuar sendin e duke kryer kështu funksion mbiemëror, madje mund të zëvendësohet edhe me ndonjë mbiemër, pa qenë sidoqoftë sinonime të plota. Megjithatë, mekanizmat semantikë e retorikë që vihen në veprim janë të njëjtë.

Për të ndërtuar kuptimin e figurshëm në këto sintagma, shfrytëzohet pjesa më e madhe e marrëdhënieve që vendosen në gjuhën **“e drejtpërdrejtë”** ndërmjet gjymtyrës bosht dhe përcaktorit. Kështu, ky i fundit mund të shënojë :

- një pjesë, gjymtyre a organ të një gjallese: **“Dhe nën thonjtë e modës edhe mjerimit/ vargu hapi krahët, shkoi mbi re”** (*“Vjen njeriu”*, f. 204); **“Kur dita niste të fekse/ sa mbyllej syri i yllit rënkonin drurët me vesë”** (*“Pelegrini i vonuar”*, f. 32); **“Qerpikët e lulediellit nën të kaltrin qiell pikojnë vesë”** (*“Udhëtoj”*, f. 187); **“Zbret lumi i malit si dashnor i marrë/ t'i puthë i etur buzët e luginës”** (*“Udhëtoj”*, f. 55); **“Do më presin krahët e diellit”** (*“Pelegrini”*, f. 104).

- Një **“send”** në kuptimin e gjerë të fjalës: **“Në sofrën e shtruar të historisë/ presin të marrin lugë të gjithë”** (*“Pelegrini”*, f. 28); **“Regëtin dyshek i luginës”** (*“Pelegrini”*, f. 43); **“Në qiellin e turbullt lecat e reve/ e lidhnin hënën si plagë”** (*“Pelegrini”*, f. 82); **“Doli arkivoli i Fjalës së vdekur”** (*“Pelegrini”*, f. 129); **“Në breg vetëtiu shpata e valës së detit”** (*“Lypësi”*, f. 102); **“Tani kam prangat e heshtjes”** (*“Pelegrini”*, f. 105) etj.

- **“lëndë”**: **“Dhe larë me bronx revolucionesh i ngjitet shkallës së lartë”** (*“Fjala gdhënd”*, f. 237); **“Vjen nata me ankth e mbushet shtrati me hithra/ me hithra nervash që kruhen e hanë”** (*“Vjen njeriu i çuditshëm”*, f. 11); **“Zjarr i hap kudo me saçma vjershe”** (*“Udhëtoj”*, f. 71);

“pëshpëritje dje në rrugë/ me **gjemba fjalësh** nëpër helm” (“Pelegriini”, f. 144) etj.

- **“Iloj”**: “Veli yt i çupërisë nëpër **mjegull vitesh** zbardh” (“Fletorka”, f. 122); **“invazion karkalecash/ inonadtë balte** leshtore/ lukuni dhe hata”, (“Fletorka”, f. 202); “Lart nën **dengje mjegujsh** mali lodhet” (“Fletorka”, f. 30) etj.
- **“vend”**: **“Haremi i bujshëm i gjarpërinjve”**, (“Fletorka”, f. 74); “Pse vallë **në pìrgje të fëmijërisë** s’vjen” (“Udhëtoj”, f. 26) etj.

Kemi edhe një numër sintagmash ku pikërisht gjymtyra bosht (në lidhje të pazakontë) mund të shënojnë:

- **Dukuri a elemente të natyrës**: “Jetova **oqeanin e luftrave**”, (“Pelegriini”, f. 125); “Në **dallgë e ëndrrave** dhe **halleve**” (“Pelegriini”, f. 183); “trupi im vështron **kënetë e jetës**” (“Fletorka”, f. 214); “Tymi – **ugar i cigares** – lërohet me gojë” (“Fletorka”, f. 201); “vjen rrotull **globi i trurit**” (“Fletorka”, f. 56); “Edhe nga **guva e gojës** sime fjalët rrëkëllehen si gurët” (“Vjen njeriu”, f. 142) etj.
- **Procese a gjendje shpirtërore, fizike, psikike, etj. të njeriut**: “Imitova /.../ **paqen e murrme të gurëve** dhe **heshtjen e bardhë të zalleve**” (“Udhëtoj”, f. 96); “Një **epsh Luçiferri** gjoja shembull për njerëzit” (“Pelegriini”, f. 159); “Dhe **gjuhë e gjelbërimeve** / në vesh më pëshpëriti” (“Udhëtoj”, f. 102); “Është **faji i pranverës**” (“Fletorka”, f. 223); “E në **agoninë e mëngjesit** tha: / “ne jemi bujq” (“Lypësi”, f. 198) etj.

2. 2. Strukturat dygjymtyrëshe emër+mbiemër

Mbiemrat kanë statusin e një klase fjalësh më vete. I ndërgjegjshëm për vecanësinë dhe mundësitë e tyre shprehëse, Agolli i ve ata në përdorim, vecanërisht, në marrëdhënie të figurshme me një emër.

Bazuar në semantikën e tyre, përgjithësisht ata ndahen në dy grupe: në mbiemra cilësorë dhe në mbiemra që në “Gramatikën” tonë të Akademisë janë quajtur mbiemra marrëdhëniorë, ndërsa sipas traditës relative, shkak u për këtë ndarje është se të parët e shprehin drejtpërdrejt tiparin e sendit, ndërsa të dytët ndërmjetazi, nëpërmjet marrëdhënieve që ekzistojnë ndërmjet këtij sendi me një send tjetër, duke u ofruar kështu me emrin që shënon këtë të fundit, po sigurisht pa qenë të njëjtë me të, sepse siç vëren prof. Xh. Lloshi “Vendosja e një mbiemri në togfjalësh me një emër nuk është thjesht të emërtuarit e një cilësie, vetie a marrëdhënieje karakteristike dalluese të sendit ë...ç. Cilësimi është edhe nxjerrja në dukje e diçkaje të brendshme për sendin, dukurinë a qënien, zbulimi ose vendosja e një lidhjeje, një vlerësim që bëhet nga një këndvështrim deri edhe krejt vetjak, subjektiv, ose, më në fund, një veprim mbi atë që shënon emri, një shndërrim ose shformim i saj” (Lloshi, Vepra: 68 - 69).

Sintagma emërore me marrëdhënie përcaktore	A - emër + emër në rasën rrjedhore	B – emër + emjër në rasën gjinore	C – emër + emër në rasën kallëzore e rrjedhore me parafjalë	D – emër + mbiemër
shembuj	Bekim perëndish	Ankthi i pikëllimit	Bark me përralla	Qyteti kryelartë
shembuj	Valle rimash	Jelet e Drinit	Enigmë prej yjesh	Shtëpi strehëvarur

Tabela 1. Llojet strukturore të sintagmës përcaktore

Mendimi i fundit na duket se vlen sidomos për rastet kur mbiemri hyn në lidhje me emra sendesh me të cilët nuk hyn zakonisht në rrafshin e drejtpërdrejtë të gjuhës, gjë që na bën t’i shohim sendet e emërtuara nga këta emra në një

dritë të re, duke i modifikuar ata më shumë sesa thjesht saktësuar e duke krijuar kështu rrugë të reja në mënyrën se si e konceptualizojmë realitetin. Tek poezia e Agollit bie në sy përdorimi me vlerë cilësore shumë të madhe i mbiemrave

të tipit marrëdhënior, që tregon se kufijtë ndërmjet këtyre grupeve nuk janë të ndarë me thikë. Një gjë e tillë ndodh, siç vërehet në “Gramatikën” e Akademisë, “Përgjithësisht kur përdoren me kuptim të fytyruar (të figurshëm)” (Likaj, Gramatika: 157)

Po sipas kësaj “Gramatike” ky kalim nuk ndodh menjëherë, por lidhet me pasurimin e semantikës së emrit që ndodhet në bazë të këtyre mbiemrave, duke sjellë kështu edhe përdorimin e figurshëm të tyre.



Ndër mbiemrat marrëdhëniorë, spikatin ata të formuar me anë të nryjzimit dhe prapashtesës – (t)ë. Te kjo klasë fjalëformuese ose kemi lidhje të reja të mbiemrave që janë të vetëqëndrueshëm tashmë, si te: “Yt zot lufton me Gjermaninë/**perandorinë e hekurt**” (“Udhëtoj”, f. 312); ose neologjizma që sidoqoftë vihen në plan të figurshëm. Në të dyja rastet kuptimi është kryesisht identifikues i emrit me të cilin është i lidhur mbiemri me atë që shërben si temë fjalëformuese e tij: “Se s’dua të ma derdhë gjakun lumë/ një **gjumë i trëndafiltë** në jatakë” (“Udhëtoj”, f. 64)(gjumë si trëndafili); “**Varka e limontë** e hënës/ shket në valët e murrme” (“Pelegrini”, f. 182) (varka si limon); “Pa eja tek unë o **qengj i argjendtë**” (“Udhëtoj”f. 12) (qengji si argjend); pra kemi raportin e objektit me lëndën e vet. Ndërsa kemi edhe raste të vështira për t’u interpretuar si: “**Guva** e kokës sime ngadalë / mbetet e zbrazur, e ftohtë, e **hiçtë**” (“Lypësi”, f. 7).

Edhe në këto ndërtime bie në sy bashkimi i figurshëm i mbiemrave me kufizimin përzgjedhës

– (+ frymor)- me një emër jofrymori: “Pas punës **toka e lodhur** pastrohet” (“Udhëtoj”, f. 22); “Udhëtar në vendin e **shpresës së thyer**” (“Pelegrini”, f. 7); “Shket në **varkën e përgjumur**” (“Pelegrini”, f. 66); “Në **strofkën e heshtur** /.../, të vdes i etur” (“Pelegrini”, f. 188); “Më bën të harroj për një çast / **zgërdheshjen e ndotur**” (“Fletorka”, f. 204); “Ka censurë për **vargun e vdekur**” (“Udhëtoj”, f. 200).

Për të treguar kufizimet përzgjedhëse semantike, domethënë kufizimet semantike në lidhjet e njësisive leksikore, përdoren përbërësit kryesore semantike të emrave, të cilët i vishen kuptimit dhe jepen nëpërmjet tipareve parësore të klasës së emrave që cilësojnë. Kështu një mbiemër si **i thinjur**, që përdoret zakonisht për njerëzit do të ketë si kufizime përzgjedhëse tiparet kryesore të këtyre emrave, domethënë (+ konkret), (+ frymor), (+ njeri). Atëherë tek: “Drini i thinjur”, kuptimi i figurshëm krijohet nga bashkimi i një emri që ka tiparet (+ konkret) (- frymor), rrjedhimisht edhe (- njeri), me një mbiemër kufizimi përzgjedhës i të cilit është – (+ njeri).

Një tip tjetër mbiemrash në një numër më të rrallë te poezia e Agollit janë kompozitat ekzocentrike, veçanërisht pronësore, të cilat janë studiuar gjerësisht nga prof. A. Kostallari në studimet “Kompozita ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese” (Kostallari, 1972: 95 – 135) dhe “Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes” (Kostallari, 1972, 141 – 147)

Në to është vënë në dukje ngjashmëria e këtyre lloj kompozitave me mbiemrat marrëdhëniorë nga mënyra e ndërmjetuar e shënimit të tiparit, po edhe dallimi nga karakteri i ndërmjetimit: në kompozitat ekzocentrike tipari i sendit që shënon emri i përcaktuar nuk bëhet me anë të një sendi tjetër, po me anë të cilësimit të një pjese të tij. Posaçërisht në poezi këto kompozita janë shqyrtuar nga A. Vehbiu (Vehbiu, 1987: 121-136), i cili ka vërejtur me të drejtë se marrëdhënia e figurshme vendoset si ndërmjet gjymtyrëve të kompozitës, ashtu edhe prej metaforës, si në shembullin: “Ai që dinte të luante sonata / **Leni, Leni flokarta**” (me flokë të arta) (“Vepra letrare 1”, f. 151); qoftë prej

krahasimit shumë i përhapur në poezinë popullore dhe në letërsinë e kultivuar pranë saj: “O **djem** o **pallëvetëtim**” (me pallë si vetëtim) (“Vepra letrare 2”, f. 202), ashtu edhe ndërmjet emrit të përcaktuar dhe gjymtyrës së parë të kompozitës mbiemërore që e përcakton: “**Qyteti** im i ri dhe **kryelartë**” (qytet me krye) (“Vepra letrare 1”, f. 188) madje do të shtonim se ka raste kur të dy këto marrëdhënie mund të gjenden së bashku në të njëjtën sintagmë, si te: “**Malet festebardhë** qëndronin të përjetshëm” (male me feste të bardhë) (“Vepra letrare 2”, f. 110).

3. Përfundime

Në një vështrim tërësor vëmë re **së pari**, se një pjesë e madhe e sintagmave metaforike në poezinë e Agollit janë dygjymtyrëshe, por hasen shpesh edhe struktura të cilat përbëhen edhe nga më shumë se një lidhje sintaksore, në rastin kur gjymtyrët e kësaj strukture janë lidhur ngushtë rreth të njëjtit element leksikor. Në këtë rast mund të themi potencialisht, se në secilën prej këtyre lidhjeve ka një marrëdhënie të figurshme, që do të thotë se këto struktura mund të përbëhen nga një ose më shumë marrëdhënie të tilla: malet krehin mjekrat, muzika lëpin plage, dielli ka shtruar sofrën, errësira ha gjymtyrët etj.

Së dyti, numri i përgjithshëm i sintagmave metaforike shkon rreth shifrës 4000, nga të cilat

rreth 1500 janë sintagma metaforike përcaktore me strukturë emër+emër, 900 janë me strukturë emër + mbiemër, 700 janë sintagma metaforike ndajshimore, 900 janë sintagma metaforike me lidhje kallëzuesore, me marrëdhënie objektore dhe me lidhje atributive të marra së bashku.

Në përfundim themi se një mori dukurish të rëndomta e prozaike, në mekanizmin tepër veprues të metaforës së Agollit estetizohen, shndërrohen në të bukura.

Bibliografia

- HASAN, Ruqaiya.(1989), *Linguistics, language, and verbal art*, Oxford University Press.
- KOSTALLARI, Androkli (1972), *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë 1972: 95 – 135; 141 – 147.
- LIKAJ, Ethem, *Gramatika e gjuh[ës shqipe II*, Tiranë: 157.
- LLOSHI, Xhevat, *Vepra*, f. 68- 69.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2009), *Pesha e fjalës shqipe*, UFO Press, Tiranë.
- VEHBIU, Ardian (1987), Vëzhgime për disa kompozita pronësore në poezinë e sotme shqiptare, “*Studime filologjike*”, nr. 1, Tiranë: 121- 136.